UNYT është një universitet privat i akreditуar në Tiranë, Shqipëri, i cili jep diploma Amerikane, i themeluar që nga viti 2002. Qëllimi ynë është të ofrojë arsim universitar me focus inteligjencë, njohuritë dhe aftësi të teknologjisë së avancuar që zhvendos përpjekjet, pasuritë intelektuale dhe burimet nga një nivel lokal në një mjedis global përmes pjesëmarrjes dhe mësimit ndër-aktiv në klasa të vogla. UNYT është një punëdhënës për mundësi të barabarta. Ne jemi duke pranuar aplikime për të plotësuar vendin e lirë në pozicionin administrativ:

TEKNIK MIRËMBAJTËS

Kryen dhe planifikon proçese rutinë si dhe parashikon të gjitha masat në lidhje me mirëmbajtjen dhe riparimin e të gjithë sistemeve dhe logjistikës brenda ambienteve të UNYT. Kryen mirëmbajtje dhe riparime në lidhje me ndërtesat, ambientet dhe pajisjet, në një ose më shumë drejtime të tilla si punime elektrike, hidraulike, rrjetin e brendshëm, lyerjen dhe ruajtjen e mjediseve.

Përgjegjësitë:

- Kryen riparime dhe mirëmbajtje të vogla dhe të mëdha të të gjitha ndërtesave dhe pajisjeve.
- Planifikon masa paraprake në lidhje me mirëmbajtjen a paisjeve dhe ambienteve
- Mbikëqyr masat e sigurisë dhe shëndetit në punë si dhe siguron që pajisjet dhe sistemet të jenë në përputhje me të gjitha rregulloret në fuqi
- Mbikëqyrja e kontraktorëve kur kryhen riparime profesionale të nevojshme
- Kontrollon dhe mirëmban sistemet e ndriçimit, kondicionimit, ngrohjes dhe pajisje të tjera të godinës
- Siguron që mjetet e punës dhe pajisjet e mirëmbajtjes të jenë në gjendje të mirë dhe të përdoren në mënyrë të sigurt etj.

Kualifikimet kryesore:

- Diplomë e shkollës profesionale ose e shkollës së mesme, Çertifikime profesionale
- Eksperiencë e mëparshme me mirëmbajtjen ose riparimet teknike
- Njohja e praktikave të shëndetit dhe sigurisë
- Preferohet njohja e gjuhës angleze

Afati i fundit për Aplikime: 26 Tetor 2026

Për më shumë informacion ne ftojmë të gjithë kandidatët e interesuar
për të vizituar faqen tonë të internetit www.unyt.edu.al (vendet e lira të punës)

Aplikantët duhet të demonstrojnë aftësinë për të forcuar profilin e departamentit dhe organizatës. Përshtatshmëria kulturore, aftësia për të bashkëpunuar mirë në një mjedis multi-etnik.

Aplikimi:

Kandidatët e kualifikuar janë të lutur të dërgojnë me email në hr@unyt.edu.al në vijim

1. Një Letër Aplikimi që detajon Kualifikimet kryesore për këtë pozicion;
2. Curriculum vitae;

SHENIME TË RËNDËSISHME:

- **VETEM** aplikimet e plota do të merren parasysh; të gjitha dokumentet duhet të dërgohen në një e-mail.
- **VETEM** kandidatët e përzgjedhur për intervistë do të kontaktohen.